

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1779 Prot

Durrës, më: 21.07.2025

V E N D I M

Nr. 82, datë 21.07 2025

PËR

"MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFËS SË STUDIMIT, PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT, PËR PROGRAME TË INTEGRUARA TË STUDIMIT, SI DHE PËR PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2 - VJEÇAR, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026".

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3/ç ku citohet se: "Autonomia financiare garantohej nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar; Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës; Vendimet respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tarifave të studimit, si dhe në relacionin Nr. 1721 prot., datë 11.07.2025 të Drejtorisë së Administrimit Financiar, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të tarifave të studimit, për studentët të cilët regjistrohen, në një program të ciklit të parë të studimeve, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët të cilët regjistrohen për herë të parë, në vitin e parë në një program studimi të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, me kohë të plotë, për vitin akademik 2025 – 2026, do të paguhet nga studentët në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët, të cilët studiojnë brenda kohës normale të studimit dhe nga viti akademik pararendës, rezultojnë me notë mesatare 6 - 8.99 dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike, për vitin akademik 2025 – 2026, të paguajnë 50 % të tarifës vjetore të shkollimit, të pasqyruar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Studentët, të cilët studiojnë brenda kohës normale të studimit dhe nga viti akademik pararendës, rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) (4 -5.99), për vitin akademik 2025 – 2026, do të paguajnë tarifën e plotë vjetore të shkollimit, të pasqyruar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë, në një program të parë studimi të ciklit të parë, do të jetë 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.
6. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë, në një program të dytë studimi të ciklit të parë, do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë.
7. Tarifa e aplikimit për studentë të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të parë të ciklit të parë nga një universitet tjetër në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë.
8. Tarifa e aplikimit për studentët të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të dytë të ciklit të parë nga një universitet tjetër në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës do të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.
9. Studentët i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit akademik përkatës. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së UAMD-së, si student përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin ai frekuenton studimet.
10. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.
11. Tarifa e shkollimit për kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi dhe përfitojnë të drejtën të ndjekin një program të dytë studimi, do të jetë sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
12. Shtetasit e huaj të cilët do të vazhdojnë studimet pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës në një program të parë ose të dytë studimi, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë të cilët vijnë studimet në programet respektive, me përjashtim rasteve kur, me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit për këta studentë.
13. Kategoritë e studentëve të cilët vijonë studimet në një program të parë të ciklit të parë dhe do të përjashtohen nga tarifa do të jenë sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar me vendim nr. 40, datë 23.01.2019.
14. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

VITI AKADEMIK 2025 - 2026

Tabela nr. 1

Tarifat e shkollimit për vitin akademik 2025 - 2026 për studentë të cilet ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të Studimeve Bachelor (BSc), në një program të Studimeve Profesionale (2 -vjeçare) ose në një program te Integruar te studimeve (PIND), pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Nr.	IAL	FAKULTETI	CIKLI I STUDIMIT	PROGRAMI I STUDIMIT	Tarifa vjetore e shkollimit per vitin akademik 2025 - 2026 (program i pare (ne leke)	Tarifa vjetore e shkollimit per vitin akademik 2025 - 2026 per program i dyte (ne leke)
1		Fakulteti i Edukimit	Bachelor dhe Profesional 2-Vjeçar	Mësuesi për Arsimin Fillor	25,000	50,000
2				Mësuesi për Arsim Parashkollor	25,000	50,000
3				Filozofi-Sociologji	25,000	50,000
4				Gjuhë-Letërsi	25,000	50,000
5				Gjuhë Angleze	25,000	50,000
6				Psikologji	25,000	50,000
7				Gjuhë Gjermane dhe Angleze	25,000	50,000
8				Profesional 2 vjeçar "Edukator për moshën 0-3 vjeçare"	25,000	50,000
9				Profesional 2 vjeçar "Gerontologji"	25,000	50,000
10				Profesional 2-vjeçar "Blogger dhe influences brendesh"	25,000	50,000
11				Punë Sociale	25,000	50,000
1	nënti i Shkencave Politike Juridike		BACHELOR	Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatie	25,000	50,000
2				Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	25,000	50,000
3				Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun	25,000	50,000
4				Administrim Publik	25,000	50,000
5				Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik	25,000	50,000



13			Menaxhim Turizëm me profil "Menaxhim Hotel Restorant"		50,000
14			Turizëm	25,000	50,000
15			Informatika Ekonomike	25,000	50,000
16			Programi i studimit Bachelor "Ekonomia Qarkulluese dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm"	25,000	50,000
17			International Business Management	25,000	50,000
18			Program studimi profesional 2 vjeçar "Guidë Turistike"	25,000	50,000
1			Teknologji Informatike	25,000	50,000
2			Shkenca Kompjuterike	25,000	50,000
3			Sisteme Informatike	25,000	50,000
4			Matematikë Informatikë	25,000	50,000
5			Multimedia dhe Televizion Dixhital	25,000	50,000
6			Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik (2 vjeçar)	25,000	50,000
7			Specialist Pajisjesh Elektronike (2 vjeçar)	25,000	50,000
			FTI		
			Bachelor dhe		
			Professional 2- vjeçar		
			Bachelor c		

